

VENDIM
Nr. 207, datë 16.3.2016

**PËR NGARKIMIN E OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE (OSHEE SHA) SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR LLOGARI TË VET DHE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për projektin “Ndërtimi i një sistemi funksional adresash”.

2. OSHEE sh.a. të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondit buxhetor të miratuar për vitin 2016, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, programi buxhetor “Shërbimi i Gjendjes Civile” dhe fondin e saj, të planifikuar për këtë projekt.

3. OSHEE sh.a., me cilësinë e organit qendror blerës, ka përgjegjësi të:

a) Bashkërendojë punën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit, sipas standardeve ligjore në fuqi, dhe miratimin e specifikimeve teknike, të dërguara nga kjo ministri;

b) Bashkërendojë punën për testimin e tregut, para publikimit të tenderit;

c) Shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë, deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi